



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-16125/23 datë:30.06.2023



Npi – 01/274 datë: 06.07.2023

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 06.07.2023, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VII- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 06.07.2023, (e enjte) në ora 09.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Përparim Ramusa, z.Adem Ramadani, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemaj Aliu, Të gjithë Drejtorët, Zyrtari ligjor, z.Lulzim Muharremi, Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti, Nga OSBE, z.Mefail Mustafa, Shefja e Kabinetit znj.Anita Kurti, z.Bajrush Rrahmani, Asistente e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët e IT-së, Nga RZSH, z.Muhamet Hoxha, Praktikantët, znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Pyetje – përgjigje,
2. Draft-Programi tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes 2023-2025 (Pas diskutimit publik)
3. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri,
4. Informatë nga DKA për përfundimin e vitit shkollorë 2022/23.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Pyetje – përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, Kryesues përveq ekstrakt procesverbalit ne kemi problem edhe me ju si Kryesues. Drejtorja e Inovacionit dhe Drejtorja e Prokururimit kërkojmë të na japin një raport pune sepse nuk ua kemi ndëgjuar zërin asnjëher.

z.Muhamet Ademaj; Pyetje për DHZE, kur pritet të vendosen Bizneset te Zona Ekonmike në Gllavicë?

znj.Albana Podvorica; Pyetje për DPUKGJ-në, lidhur me parkun në Davidovc, a janë të përfshira edhe dëmet e shkaktuara te ky park? Pyetje për DSHP-në, qka po bëni me mbeturinat në Komunën e Shtimes? Pyetje për DKA-në, kur do të bëni renovimin e paraleles së ndarë në Davidovc?

Adem Ramadani; Pyetje për DSHP-në, lidhur me vërshimet, kërkojë një raport për dëmet e shkaktuara nga vërshimet?

Pika 2

Draft-Programi tre vjeçar për banim social në Komunën e Shtimes 2023-2025 (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Isa Haxhiut.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Përshëndetje, Materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë, ka qenë edhe në diskutim publik, kështu që unë nuk kam çka me shtu më shumë, vetëm nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem. Ju ftoj që ta votoni këtë program për banim social në komunën tonë.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht miratoi, Programin tre vjeçar për banim social në Komunën e Shtimes 2023-2025.**

Pika 3

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Në mbledhjen e fundit e kemi shty këtë pikë të rendit të ditës, jemi dakorduar që ta bëjmë një zgjidhje politike për këtë anëtarë dhe për këtë Komitet. Edhe dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht kemi vendosur që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e Kuvendit për muajin Gusht.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, pikërisht te pika e radhës, në mbledhjen paraprake jemi dakorduar, që të ulemi dhe të diskutojmë. Por për procedurën ligjore unë po bëjë pyetje a është opinion i VV-së a është i MAPL-së?

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ne nuk japim opinion por kemi kërkuar opinion nga MAPL-ja. Dhe kemi bërë një kërkesë si grup parlamentar i Vetvendosjes në MAPL-ë.

z.Rexhep Gashi; Ne nuk jemi për me shty sepse nuk ka nevojë.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, në këtë Komitet kemi bërë shumë diskutime, po ndihem keq që po bëhet fjalë për emrin tim. Ankesë ka bërë grupi parlamentar i subjektit politik të Vetëvendosjes. Ka delegatë në këtë opinion?

Sekretaria Idajet Rexhepi; Sqaroi procedurën administrative të Vendimit- Npi-01/76. Grupi parlamentar i subjektit politik të Vetëvendosjes, ka bërë ankesë në MAPL-ë lidhur me procedurën e zëvendësimit të anëtares së Komitetit për Politikë dhe Financa znj.Heroina Selmani e cila vullnetarisht ka dhënë dorheqje për arsyet e saja personale. Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes që ta rishqyrtojë edhe një herë vendimin e Kuvendit Npi-01/76 për shkak se nuk është në përputhje me Ligjin, duke sqaruar se kandidati që duhet ta zëvendësojë kandidatin e KPF-së që është larguar, duhet të jetë nga i njëjti subjekt politik si dhe të jetë i gjinisë së njëjt.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Mua më duhet të largohem me një përshëndetje për të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët. Më në fund po e vejmë gurthemelin e ndërtimit të rrugës "Tranzit" dhe rrugës "Shtime-Lipjan", dhe me këtë rast ju ftoj edhe juve të gjithëve që të merrni pjesë në hapjen e fillimit të punimeve në këto dy rrugë shumë të rëndësishme për komunën tonë.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, faleminderit Kryetarë për ftesën, por çdo insitucion e ka punën e vet ne e kryejmë punën tonë, e ju e kryeni të juajën, ama mos e merr ngat zemre se ka qenë projekt dem baba dem. Unë po shpresoj të kryhet sa më shpejtë. Te pika e rendit të ditës. U tha se qysh pe pengon emri i anëtarit të KPF-së. Kjo është një demaskim i vetvetes. PDK-ja nuk e ka propozuar Reshatin në KPF. Ka qenë vullnet i anëtarëve të Kuvendit. Për me u hjek Reshati duhet me shkarku këtë Kuvend. Unë jam për me u shty dhe me u zgjidhë kjo gjendje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë po kërkojë me u shty sepse edhe ashtu nuk kemi zgjidhje. Nuk mund të marrim vendime që e dimë paraprakisht se do të na kthehen nga Ministria.

znj.Adelina Beqa; Kërkojë që Sanija të del publikisht dhe të sqaron se a është propozuar Reshati nga PDK-ja apo nga kush.

z.Reshat Mujota; Ma morri pyetjen Adelina, më vjen keq që Sanija ka ra në grackën e grupit që e ka nënshkru një dokument, le të mbetet për muajin Gusht, por le të rregullohet kuota se këtu nuk ka shkelje ligji. Le të dakordohen antëtarët e VV-së se a e mbështesin këtë opinion.

z.Përparim Ramusa; Në mbledhjen e radhës, e jo në mbledhjet e radhës.

z.Rrahman Jakupi; Ne e votuam si pikë e rendit të ditës, pse prap me u vazhdu. Mbylle këtë pikë.

z.Rexhep Gashi; Të definohet me ndryshimin e Kuotës.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht vendosi që pika e 3 e rendit të ditës “Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/76 Për plotësimin e KPF me anëtarë të ri”, të shtyhet për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës të Kuvendit.**

Pika 4

Informatë nga DKA për përfundimin e vitit shkollorë 2022/23

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha znj.Yllkë Fejzullahut.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Përshëndetje, tani e kemi informatën e plotë që nga fillimi, e kemi vonuar pak por me arsyetimin se kemi dashtë me i përmbyllur të gjitha të dhënat nga Shkollat. Informatën e keni pranuar të shkruar me E-mail dhe e keni lexuar prandaj unë do të ndalem te interpretimet më të rëndësishme, në vazhdim lexoi informatën (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përpiqem që të përgjigjem.

znj.Adelina Beqa; Faleminderit për informatën, mirëpo e kemi marrë të vonuar, sa e kam lexuar po lidhem te Çerdhja “Albiona Asllani”, nuk po më gëzon fakti që nuk po i përmendni edhe ato që kanë kontribuar. Salla e sportit pse nuk është funksionale te shkolla “Bajram Curri” në Petrovë, çfarë po bëni në këtë drejtim, pse nuk është funksionale kjo sallë? Pyetja tjetër është se a mundesh me na dhënë një numër se sa janë orët e humbura?

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Sa i përket Çerdhes që u përmend në raport nuk është përmendur asnjëher me emër kontribuesit në këtë Çerdhe, prandaj unë i falënderoj të gjithë kontribuesit pa përmendur emra konkret. Secili drejtor e ka një meritë për punën që e bëjnë. Për sallën e sportit jemi duke punuar për rifunksionalizimin e sajë. Për orët e humbura përgjigjen ta jap me shkrim sepse nuk i kam të dhënat e kompletuara.

znj.Adelina Beqa; Nuk e thashë me qëllim por drejtoresha ka kontribuar me mjete të veta. Për sallën e shkollës së Petrovës vetë jeni duke kontribuar si VV mos me qenë funksionale. E për orët e humbura duhet me ardhë në mbledhje e përgaditur me informata.

z.Hamëz Tërshani; Faleminderit, i përmendi Adelina të gjitha, e nuk po bënë me i përmend prap. Shumica e informatave ishin procesverbale. E ka harruar me përmend çështjen e pagesave. Jeni në gjysmën e mandatit e 95% të projekteve ishin të vazhduara nga më herët. A ka ndonjë sallë sportive të re a ka ndonjë shkollë të re, qka keni hap ju, sepse tash veq jeni në gjysmën e mandatit.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Ky material është pasqyra e punës së shekullave dhe e institucioneve, e ju po e quani procedurale.

Në vazhdim përmendi disa projekte që nuk kanë qenë vazhdimësi e projekteve, dmth. përveç renovimit të shkollave të gjitha të tjerat janë projekte tona. Psh. rritja e bursave është bërë nga ne e shumë të tjera.

z.Hamëz Tërshani; Projekti për është inicuar prej neve, salla e sportit në shkollën e Petrovës ka qenë e ndërtuar nga ne, e ju nuk po mundeni me funksionalizuar. Pyetja është shumë e sinqertë qka ka ndryshuar me qeverisjen e juaj.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për informatën, ka ardhur me vonesë por nuk po e interpreton drejt. Qe dy vite qeverisje asgjë nuk keni bërë. PDK-ja ka bërë tri shkolla e ju as fotokopjet nuk po mundeni me i rregullua. Qe pesë muaj drejtoresha asnjëherë nuk ka shkuar me i vizitua. Te orët e humbura VV-ja i ka 831 orë të humbura. Kalushmëria në testin e maturës nga 299 nxënës vetëm 139 kanë kaluar. Te Gjimnazi me far logjike me planifikuar më shumë nxënës nëp drejtimin gjuhësor se sa në drejtimin shkencor. Unë kërkojë me u shty kjo pikë dhe me ardhë më e përgaditur.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Vonesa është si rezultat i grumbullimit të rezultateve nga shkollat. Sa i përket testit të maturës sigurisht që duhet që nxënësit të jenë më të përgaditur e nuk varet vetëm nga numrat.

z.Përparim Ramusa; Ti drejtoreshë vetë po e demanton vetveten 8311 orë të humbura po ti lexojë të dhënat.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Unë e përmenda arsyen e mungesës të orëve të humbura.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për informatën drejtoreshë, si profesor i Arsimit e kuptoj mirë për vështërsitë që keni në Arsim. Kërkoj nga DKA që të punojë më shumë me të gjithë për një sukses më të mirë. E përgëzojë drejtorshën për punën dhe gjithë angazhimin.

znj.Albana Podvorica; Pajtohem që informata është me vonesë. A egziston mundësia që te Çerdhja “Albiona Asllani” të lirohen nga pagesa disa kategori të prindërve me kushte të vështira? Për renovimin e shkollave a keni bërë diçka. A është paraparë renovimi i shkollës në Davidovc?

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Për renovimin e shkollës në Davidovc janë ndarë rreth 19 mijë euro. Jemi fokusuar në dy shkolla në Godanc që ka probleme me pullazin dhe te shkolla Profesionale.

znj.Besartë Musliu-Spahija; Faleminderit për informatën, unë kam bërë pyetje, në Zborc nuk ka pas zëvendësim dhe nuk janë mbajtur orët çka keni ndërmarrë?

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Sqaroi se mësimdhënësja ka pas probleme shëndetësore dhe e kemi pas të pamundur për me bërë zgjidhje në përputhje me ligjin. Nëse nuk ndyshohet rregullorja do ta kemi problemin e njëjtë me mungesën e orëve. Po ashtu kemi edhe mungesë të kuadrit.

znj.Albana Podvorica; Po ndërlidhem te pagesa për fëmijët në Çerdhe të cilët kanë raport të mjekut, unë mendoj se është e mundur të lirohen nga pagesa sepse këtë e kanë kërkuar edhe prindërit.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Çështjen e pagesës do ta marrë me prioritet për ta trajtuar më mirë.

znj.Zejnije Veliu; E falënderoj drejtoreshën për informatën. Ka orë të humbura dhe do të ketë vazhdimisht. Te procedurat kemi gati 2 muaj pa një zëvendësim. Për me e ndërtuar një shkollë duhet të bëhet planifikimi i mirë e këtu duhet të planifikohet edhe numri i nxënësve, edhe kosto e nxemjes e ndriqimit etj. Shkolla në Pjetershticë ka m² shumë, Kulmi i rrumbullakët pikon, e tash duhet me rregullu. Është Gjeneratori në këtë shkollë që nuk funksionon. Dmth keqplanifikimi na bjen në një situatë për tu përballur me renovime. Është mirë që është rritur shuma e bursave, është e mirëseardhur për të gjithë e jo vetëm për një subjekt.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për informatën, edhe pse e kemi marrë me vones. Te Gjimanzi a e ke parë që profesorin e fizikës e ke në mungesë. Te shkolla e Petrovës, deri sa u pranua Zejnija ka pas mungesë të arsimtarit. Edhe te shkollat tjera ka raste kur arsimtari orët nuk i mbanë e rrogën e merr të plotë. Nuk kanë me ndodhë më me pas orë të humbura. Profesorëve pushim të këndshëm për këtë vit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Drejtoreshë a ban me ditë kush e nënshkruan pagën për arsimtarin që mungon siç e tha Reshati.

znj.Rrezartë Ramadani; Faleminderit për informatën. Te mësuesit që dalin në pension a duhet të zëvendësohen me kohë sepse për ta dihet saktë se kur shkojnë. Në Komitetin për Komunitete e kemi informatën se vetëm 3 nxënës janë rexhistruar, a mund të bëni një fushatë për rexhistrimin e nxënësve të Komunitetit.

znj.Zejnije Veliu; Unë kam shkuar në Petrovë, për me dhënë mësim, dhe mund të them se aty nuk kam gjetë orë të humbura e ju mund të diskutoni qfarë të doni, por unë do të përgjigjem sa mundem e sa di.

z.Reshat Mujota; Nuk e pata me të keq për Zjenijen, kur keni shkuar ju orët kanë humbur para teje, shyqyr që je pranuar e është shumë mirë. Nuk thashë pse je shku por kur po ka interese po hapet konkursi.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, po lidhem me diskutimin e Zejnijës për shkollën e Pjetershticës, pyetje për drejtoreshën se a e ke vizitu shkollën e Pjetershticës me gjith problemet e saja.

z.Rexhep Gashi; Faleminderit për informatën, i ka edhe anët pozitive edhe negative sa i përket orëve të humbura nga muaji tetorë i kemi të pa notuar 76 nxënës. Pse kanë mbetur të pa notuar këta nxënës? Te investimet kapitale është kah bëhet një punë. Te shkolla “Lasgush Poradeci” në Muzeqinë e kanë pranuar PDK-ja dy tri herë e tash ju po e pranoni teknikisht me të njëjtat gabime. Te shkolla në Pjetërshticë, drejtori

ka thënë se gjeneratori punon mirë, mirëpo e ka kërkuar vetëm një mbulesë për mbrojtjen e gjeneratorit nga shiu.

z.Përparim Ramusa; Në emër të grupi parlamentar të PDK-së kemi vërejtje në raport. Këshilltarit nuk është e udhës me ja ndalë fjalën. Pastaj duhet me pranuar se shkollat janë meritë e PDK-së dhe nuk ka zararë pse është shkolla e madhe. Zejniye mos e merr ti rolin e militantes.

z.Rrahman Jakupi; Zotri Ramusa kërkoi që me u shty kjo pikë, edhe unëmë i qëndrojë pranë. Pse me u shty? Arsyeja është se duhet me i ditë të gjitha të dhënat. Për herë të parë VV-ja nuk do të bëjë shpërndarje të librave deri në klasën e nëntë. Qe dy vite ka shumë shkelje, është degradim i Arsimit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ku e ke marrë këto informacione të librave.

z.Rrahman Jakupi; Ty nuk të intereson se ku i marrë unë informacionet.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora:11:36h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

